

Procesverbal

Nga Mbledhja VI (e gjashtë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 27.06.2024

Rend Dite

- 1) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën VI; dhe
- 2) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e gjashtë të rregullt për vitin 2024 të KPF-së! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Para se ta hedhim në votim rendin e ditës, a do dikush me e marrë fjalën rreth këtij rendi të ditës? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 5 vota pra, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i KAB 2025-2027. E hapim diskutimin.

Artan Loshaj: Mirëmengjesi për të gjithë! Para se me ia nis, po më intereson te Lista e shpenzimeve kapitale për vitin 2025-2027, e kam thënë edhe disa herë, do ta përsëris edhe sot. Kjo Listë është copy-paste e PDK-së, bile pak më tepër, mbi 90% është ndërtim, kubëzim, kubëzim, kubëzim... ia keni marrë dorën si shumë. Po më vjen se keni ra si pula në grun, me këto kubëzime, me këto sende. Keni ardhë në pushtet me akuza, kubëzim, kubëzim, kubëzim, edhe stadiumi, stadiumi, stadiumi, tash i kam pa vetëm tri apo katër ndriçime. Të gjitha janë kubëzim. Por nëse, nuk është problem, se këtë edhe qytetarët e shohin. Po mu po më intereson në fshatin Rrenc, kryetar. Ka dalë një projekt dyvjeçar për kubëzimin e fshatit 2024-2025. Ne vitin e kaluar këtu në Kuvend i kemi ndarë 20 mijë euro për fshatin Rrenc për ndriçimin. Projekti i ndriçimit është bërë para katër viteve dhe ka kushtue 30 mijë euro. Edhe, ju tash, vitin e kaluar i keni ndarë 20,000. Kam shkuë në Urbanizëm, jam interesue, hala buk ka dalë në tender. Ndërsa në fshatin Rrenc 5 mijë euro i kemi ndarë para nja dy muaje më duket këtu, edhe 70 mijë euro të vitit të kaluar, edhe e keni bërë një projekt dyvjeçar në fshatin Rrenc. Po më vjen shumë mirë, ju kam thënë unë që për krejt fshatrat, sidomos për në Rrenc, edhe me ari me shtrua nuk më pengon. Por po më pengon qasja se, tash nëse ky projekti i ndriçimit me 20 mijë euro nuk kalon, a do të bëni edhe këtë projekt dyvjeçar edhe ku do të merrni pare, kur veç i keni ndarë për fshatin Rrenc. Një pyetje edhe për ty

kryetar, edhe për kryesuesen, se keni qenë të dy nëpër fshat. Mirë është shumë, keni qenë i keni mat rrugët, po më vjen mirë që jeni të interesuar për atë fshat. Por po më intereson mu, 30 mijë euro, edhe një herë ju thashë, ka kushtue projekti, e ju i keni ndarë 20 mijë. A do të mundeni me e mbulue me qeto 20 mijë eurot? Edhe, në qoftë se nuk bëhet ky projekt, nuk është projekt dyvjeçar, ku projekt do të dështojë krejt. Ose, në qoftë se ka mundësi me më shpjegue, ku do të merrni pare për mos me dështue ky projekt. Edhe këtu, prapë po shkoj te stadiumi, se nesër kemi me folë më shumë, e kemi lënë për me folë ma tepër. I keni ndarë 158 mijë euro. Unë qe sa herë jam duke diskutue për këtë, po më vjen se jam bo edhe pak monoton. 220 mijë janë ndarë nga pushteti i kaluar, të cilin e ka mbështet e gjithë Asambleja. 230 mijë euro i keni pru harxhimet që i keni bo këtë vit, ku janë bo, a në rrugë, a s'e di ku i keni bo, se në stadion s'keni bo asnjë cent s'keni investue. Rrugën e ka KFOR-i, po s'është me rëndësi, në fund kur të vjen do të bisedojmë për atë. Sot keni me e prë në ora 17:00 shiritin e stadionit? Mirë, deri tash unë po e di që.. le të na japë informata kryetari. Në qoftë se e pritni shiritin, çfarë merita keni, kur 200 mijë euro i ka investue FFK-ja, s'po mundi me e kuptue unë, çfarë shiriti, kur aty rrethojat janë pa bo – incizime kam – para nja tri a katër ditëve, se çdo ditë dal me luft aty me fëmijët. Thashë, 200 mijë euro të stadionit, po e pritni shiritin, çfarë merit aka pushteti në atë stadion, kur atë stadiumin e ka bo FFK-ja? Në atë stadion – edhe mirë, kush e ka bo s'është me rëndësi – po rrethojat nuk janë. Aty makinat kanë hy brenda në stadion, në qoftë se nuk e dini. Stadioni para se me e pre shiritin ka nis me u prish, kryetar. Është mirë që po e boni, po është dashtë me i bo një herë rrethojat, me e bo zhveshtoren, ani me e bo stadiumin, me e mshelë me çelës, a me e vu një roje, me vu një kamerë, se ka me dështue si herën e parë që ka dështue, ka me dështue, sikur ajo shtëpia që ka qenë e ndërtume aty për piknik. Domethënë, krejt mbrapsht, veç për poena politike po e boni, mu qeshtu po më vjen.

Munir Jonuzi:

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues! Të nderuar asambleistë, anëtarë të KPF-së! I nderuar përfaqësues i OSBE-së dhe ju të tjerë! Ju përshëndes të gjithëve! Siç e dini, mbrëmë kemi kaluar një situatë shumë të rëndë, si pasojë e reshjeve të dendura të shiut dhe breshërit, kemi pas shumë dëme në fshatrat që janë të vendosura rrëzë Maleve të Sharrit, në pjesën lindore të Komunës. Unë si kryetar, bashkë me stafin dhe kryesuesen kemi qenë në vend të ngjarjes, kemi

parë. Janë dëmet shumë të mëdha, sidomos në fshatin Kuk dhe në fshatin Kosavë, pastaj në Blaç, Zaplluxhe, Pllajnik, dhe ndoshta edhe në Xërxe janë dëmet pak më të vogla. Ne dje tërë pasditën jemi marrë me këtë çështje, edhe sot në mëngjes. Më vonë kemi planifikue disa takime me zyrtarë të lartë të Qeverisë. Edhë në mëngjes kemi ndërmarrë disa masa për sanimin e gjendjes. Sa i përket pyetjeve që m'u bënë nga ana e Artanit, ne kemi ndarë mjete të mjaftueshme për kubëzimin e rrugëve në fshatin Rrenc, do të kubëzohen të gjitha rrugët të cilat kanë mbet pa u kubëzue. Nga viti i kaluar kemi ndarë 20 mijë euro, tenderi ka shkue në Zyrë të Prokurimit, është në procedurë. Ky projekt nuk do të dështojë, sepse ne jemi të interesuar që ndriçimi në fshatin Rrenc të përfundojë dhe ju garantoj se nuk ka me dështue. Sa i përket stadionit, ne e kemi shtyrë hapjen e fushës për në kohë të pacaktuar, për shkak të situatës që e përmenda në fillim të diskutimit. Nuk kemi kohë që sot të bëjmë hapjen e fushës së stadionit, sepse kemi punë shumë më të mëdha, të rëndësishme, të cilat kanë ardhë si pasojë e reshjeve dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme, e që janë më prioritare se hapja e stadionit. Ne në thirrje e kemi bërë përrurimin e fushës së stadionit, e jo të stadionit në përgjithësi. E kemi cek për mos me shfaq huti, se stadioni ende nuk ka përfundue krejt. Kjo pjesa që ka përfundue është projekt i përbashkët i Komuës dhe i Federatës. Federata e ka edhe një projekt tjetër: zhveshtoren edhe rrethojën. Ne kemi ndarë me buxhetin e vitit të ardhshëm edhe 180 mijë euro, mirëpo sigurisht në shtator një pjesë e këtyre mjeteve do të hiqen, sepse pasi është çuar KAB-i, kemi marrë konfirmimin nga MAPL-ja që e kemi fitue projektin për stazën e ecjes dhe ndriçimin e saj deri te stadioni. Kështu që ato mjete ne do t'i hekim, do t'i orientojmë diku tjetër, në shtator. Dhe siç e dini, këto mjete janë mjete të komunitetit shqiptar, këto nuk kanë hy në ndarjen e drejtë të buxhetit. Për stadionin unë mendoj që nuk duhet të na dhimben paret, se janë për një kategori të njerëzve, të futbolldashësve të cilët kanë pas nevojë ta kenë këtë stadion. Ne do ta kompletojmë këtë stadion edhe me staf, edhe me roje, edhe me kamerë, edhe me ndriçim. Kështu që, tani radha është e Federatës që t'i kryejë punët që i ka në kontratë, dhe pastaj ne ato mjete që i kemi ndarë, një pjesë do t'i shfrytëzojmë për ndërtimin e tribinave. Sa i përket diskutimit të Munirit për buxhetin, është e vërtetë që në shtator buxheti mund të pësojë ndryshime, me arsyetimet dhe me propozimet e juaja. Po ne, me sa e di unë, i kemi mbajtur afër tri dëgjime buxhetore, me dokumentacion janë mbajtur dëgjime buxhetore këtu, kanë qenë edhe të përcjellura përmes mjeteve të informimit. Për atë edhe ekzistojnë dy takime të Asamblesë, ky është buxheti fillestar, ndërsa në shtator është buxheti përfundimtar dhe ndërkohë ne mund të marrim

propozime të arsyeshme dhe ne mund ta ndryshojmë këtë buxhetin fillestar që e keni marrë ju si delegatë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Po, z.kryetar, për fjalimin e parë, edhe ne ndjejmë keqardhje për gjendjen e jashtëzakonshme që është bo nëpër fshatrat e Opojës. Sa për dritat e fshatit Rrenc, ishalla bëhen, se kam qef me u bo, po jam i dyshimit unë, se projekti ka kushtue 30 mijë euro që e kemi bo na. Tash, çmimet kanë shkue lart, 20 mijë euro i ke. Unë ka qef me e ndreq, edhe ishalla me 15 mijë e bon ti, edhe ishalla nuk dështon. Veç po të them se nuk ka dalë tenderi, deri dje nuk ka dalë, unë kam qenë kam pyet dje për me qenë i përgatitet sot për seancë, tenderi nuk është gati. Mos thuaj ka shkue në Zyrën e Prokurimit. Nuk është i bërë gati. Tash, ja ty të kanë rrejt, ja mu po më rrejnë. Dje kam qenë tanë ditën, i ke edhe kamerat, projekti hala nuk është gati, Sabahat Hasani është në pushim. Asambleistit nuk i jipen informata, a? Është publike ajo, kryetar. Nuk është, në Zyrën e Prokurimit nuk e kie. Projektin nuk e kie gati, kryetar, se s'po due debat direkt me ty, projektin nuk e kie gati se Sabahat Hasani e ka projektin edhe Sabahat Hasani është në pushim. Veç si ta ke thirrë mas orës 16:00 ti, me e pru dje, e sot me e qit aty. E dyta, për stadiumin që po thuesh nuk më dhimben paret. Është shumë mirë që nuk po të dhimben paret – jo jo, nuk po na dhimben paret kërkuj, se me m'u dhimbt paret unë s'foli. Unë atë stadion kam qef me e ndreq, se fëmijët tanë luajnë aty, njëri prej tyre është fëmija jem. Unë tanë ditën e lume dal e luj aty futboll. Problemi është se një video e drejtorit të Administratës që të ka postue ty që ke folë në zgjedhje, që po bëhet stadioni, po nuk e ka dhënë deri në fund. Se ti e ke thënë në fund, kur do ta ndreqim stadionin – tash ta lëshoj – stadionin do ta ndreqim deri në fund të mandatit. Të ka pyet Jeta Xharra. Deri në fund të mandatit – po pse s'po e bësh tash – po është një problem gjyqësor më ka thënë ish-kryetari. Shabani të ka thënë ty është një problem gjyqësor. Edhe na keni akuzue neve për keqpërdorime. Të njëjtin mbikëqyrës të PDK-së, që e kemi ndreq atë stadionin – mirë a keq – të njëjtin mbikëqyrës e keni edhe ju. Qetu po më lindin dyshimet mu. Tash po thoni zhveshtoret do t'i bëjmë prej fillimit, do t'i prishim. Ato duhet me u prish, rrethojat duhet me u prish, me u ndreq të mira. Po qato deri më sot që i ndreqet, ku shkuan ato pare. Kush duhet me dhënë llogari për ato? Ti e ke marrë përgjegjësinë qysh e ke gjet Komunën. Ti me ato problemet që i ke gjet, s'po duesh me u marrë ti. Të njëjtin kryeinspektor aty, mbikëqyrësin e punimeve e kemi pas na, na keni akuzue, të njëjtin e keni edhe ju. Pse? Ku është problemi? Deri më sot kanë shkue 450 mijë, edhe 200 mijë që po bëhe kjo tepihu, 600 mijë, edhe 100 mijë projekti, 1 milion euro për stadionin, kërkund s'është kryetar. Po më thuesh kemi me i bo dritat, kemi me i bo kamerat edhe ato. Kerrrat kanë hi, kryetar. Deri t'i

bosh kamerat, deri ta bosh rojën, deri t'i bosh rrethojat, ai stadion ka me shkue prej zeros. Nuk po ta bëj për inat, i kam videot që kanë hi, se unë dje kam dalë me lujt me top, pardje, unë çdo ditë jam në stadion. Atë duhet me e rujt. Unë të thashë edhe një herë, deri të bëhen rrethojat, deri të del tenderi, deri të bëhen zhveshtoret, stadioni ka me shkue në zero. Unë e di që po doni me bo huti aty. Jo, me atë stadion dikush ka me dhënë përgjegjësi. Pa marrë parasysh, a ish-kryetari, a ky kryetari, a mbikëqyrësi. Dikush duhet me dhënë llogari. E tash ato 1 milion euro edhe me thënë hajt se po i bëjmë për carrokët. Jo! Një herë është dashtë me e bo rrethojën, është dashtë me e bo rrethojën, është dashtë me i vu kamerat, është dashtë me e vu rojën, e shtrajmë stadionin edhe dalim. Temeli nuk është kërkund, ju e keni qit kulmin. S'është e drejtë kjo, e që doni me u mbrojt ju, që doni me bo politikë, politikë s'bëhet me 1 milionë euro kryetar.

Bexhet Xheladini: Artan, unë përgjigjem për paret prej momentit kur jam zgjedhë kryetar. Për paret që i keni shpenzue ju, i keni çue në ujë, s'keni bo kurgjo – ke qenë edhe ti asambleist. Edhe, a e dish ku është Prokuroria? Nëse nuk e dish, ta kallxoj. Çoje lëndën! Po nëse ke dyshim, çoje edhe këtë lëndën tjetër. Prej momentit kur e kam marrë unë detyrën, deri më sot. Dinamikën e punimeve - ju nuk jeni inxhinier - e cakton kontrata. Ne e kemi një kontratë me FFK-në edhe aty shkruan qartë se cilat punë duhet me u krye në fillim, cilat në mes, e cilat në fund. Ne, për momentin nuk po më kujtohet, diku afër 130 mijë euro si Komunë i kemi ndarë, pjesën tjetër ka me e dhënë Federata. Trasimin e ka bërë KFOR-i. Asfaltimi kryhet brenda muajit, edhe aty kemi dhënë ne mjete, po jo të gjitha tonat, gjysma e mjeteve janë nga MZHR-ja. Për stazat edhe ndriçimin, ne do t'i ndajmë 47 mijë euro – i kemi ndarë vitin e kaluar. Kurse 50 mijë euro do t'i ndajë MAPL-ja. Këto janë mjetet e Komunës që i kemi ndarë na, diku afër 200 mijë euro. Edhe 100 mijë ndoshta që do t'i ndajmë për vitin e ardhshëm, për tribinat. Nuk është fjala për 1 milion euro, por është fjala për 200 mijë euro që i ka ndarë Komuna, unë prej sa jam kryetar. Ndërsa, pjesën kur keni qenë ju në pushtet, nëse ti ke diçka mujsh me u marrë me gjykatën apo prokurorinë. Unë s'kam kohë me u marrë, se kam punë tjera. Edhe sa i përket mbikëqyrësit, edhe asaj zhveshtores, unë e kam formue një Komision prej ekspertëve i cili ka me shkue me e shique atë zhveshtoren. Unë kam qenë e kam pa, edhe e kam formue Komisionin i cili ka me e pru një vendim me e renovue këtë, apo me e prish, me e bo një të re. Nëse e bjer vendimin Komisioni me e prish, ne si Komunë do ta prishim, pastaj Federata do ta ndreq të re. Nëse Komisioni e bjer vendimin që duhet me u renovue objekti ekzistues, atëherë FFK-ja do ta renovojë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, vetë ju si kandidat për kryetar, dhe z.Kolloni si kryetar i LDK-së, në televizione publike keni deklarue. Ke thënë ka keqpërdorime. Kur ka pas keqpërdorime edhe ku ke thënë problemet janë nëpër gjykata – tash ta lëshoj, po nesër po due me të lëshue publikisht – pse e ke pranue me i vazhdue punimet qaty? Ti vetë po i amnistosh ata edhe mu po më thuash çoi në gjykatë. Në qoftë se ka pas keqpërdorime. Unë po të them 220 mijë i kemi harxhue në kohën e PDK-së - 230 mijë u keni pru material ju - që janë harxhue deri më sot. Bëjnë 430 mijë. 200 mijë tepihu, 600 mijë, 100 mijë rrethojat e ato, 700 mijë. 185 mijë a i ke nda, a po bëhen 900 mijë, a po bëhen 1 milion kryetar? Ti në qoftë se ke thënë më ka thënë kryetari ka do probleme gjyqësore – se të ka thënë kuse ty, ish-kryetari Shabani – ti pse i vazhdove punimet qaty? Pse i amnistove? Ju vetë i keni amnistue. Tash po thuesh e kam bo një Komision me e pa zhveshtoren. Në qoftë se është gabim ajo, pse me e prish atë, pse me bo renovim. Thuesh paja ko, kush e ka bo qeto, a po e shohish sa keq është bo, nuk është bo drenazhimi, nuk është bo ajo, kjo lëndë duhet me shkue në gjykatë. Ose mos e ço ti në gjykatë, prej foltores e thirrish gjykatën. E thirrish prokurorinë prej foltores. Ti vetë i ke amnistue edhe ma e keqja po më vjen, unë të thashë, prej krejt qeto keqpërdorimet që po pretendoni që janë bo – se në qoftë se prishet një stadion edhe vonohet i ri, ai ka pas gabime. Në qoftë se një zhveshtore e prishish, ajo është bo keq, domethënë vetë po i amnistojsh. Edhe ma e keqja po të them, veç ma shumë që kam dalë me folë, ish-mbikëqyrësin e PDK-së e kie mbikëqyrës të punimeve. Qekjo pak mu po më jep me dyshue që ju po doni me i amnistue njerëzit aty. Nuk mundesh me amnistue njerëz aty, kryetar. Vetë qat dëgjimin unë ta kam lënë nesër, pesë sekonda po ta lëshoj në fund ku ke thënë: më ka thënë kryetari ka keqpërdorime. Nuk e kam thënë unë, kryetar, këtë. Ti ke thënë, me ka thënë kryetari ka do probleme me gjykata. Po mirë de, pse i vazhdove punimet? E pritshe gjykatën me vazhdue, edhe jo me vazhdue me i shti edhe 500-600 mijë euro.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se s'ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë këtë pikë. Atëherë, kalojmë te pika e dytë, te pika eventuale. Para se me jua dhënë fjalën për pikën e dytë, siç e dini, dje në disa fshatra të Opojës ka pas vërshime shumë të mëdha. Unë si kryesuese kam pas shumë telefonata prej shumë asambleistëve dhe kam dalë në terren, bashkë me kryetarin e Komunës dhe disa drejtorë, por gjendja ishte jashtëzakonisht e rënduar dhe ishin të shqetësuar të gjithë qytetarët. Ne si Kuvend, brenda mundësive ligjore do t'i ndihmojmë këto fshatra. Unë deshta një falënderim shumë të

veçantë t'ia bëj drejtorit të Shërbimeve Publike, z.Nuhija Tairovci, që që mbrëmë shumë vonë, gjatë gjithë natës, edhe pse është drejtpërdrejt i kyçur ky si drejtor i Shërbimeve Publike. Andaj, me shumë keqardhje i kam pa të gjitha fshatrat, deri në ora 01:00 të natës kam qenë në të gjitha fshatrat dhe gjendja është shumë e keqe dhe shumë e rënduar. Më erdhi mirë që kryetari i Komunës ka vendos që sot mos të pritët shiriti në stadionin, për arsye se duhet me qenë me qytetarët. Edhe nuk duhet edhe shumë diskutime të ketë rreth kësaj. Dua të ju falënderoj të gjithë stafin e kryetarit që kanë qëndruar deri në orët e vona nëpër fshatrat e Opojës. Te pika eventuale kush do me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Po, rreth kësaj gjendjes. Edhe më herët shpreha keqardhje. Më vjen mirë që ju si kryesuese, në emër të krejt Kuvendit keni shkue. Më vjen mirë edhe kryetari që ka dalë me drejtorët. Po unë dua me e pyet kryetarin edhe juve, a do të formoni ndonjë Komision komunal, apo ndonjë Komision bashkë edhe me qeverinë, se dëmet janë shumë të mëdha. Njëfarë informate pak me na dhënë, në qoftë se ka mundësi.

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderuar pjesëmarrës në këtë Komitet! Deshta me u ndërlidhë me çështjen e vërshimeve, fatkeqësisë natyrore. Është e vërtetë që këto janë gjëra që ndodhin, mirëpo ajo që ne duhet të ndërmarrim edhe të bëjmë është parandalimi, me njëfarë mënyre, që këto mos të ndodhin ose të sanohen, përpara se të bëjnë ose të shkaktojnë dëmtime. Mirë që keni dalë në terren, i pashë fotot. Kemi dalë në terren edhe na, po pa selfie, se ka qenë koha mjegull, nuk dilshin fotot e bukura dje. Ajo që dashta me thënë edhe me kërkue publikisht për ju është që, njëra prej shkaktarëve të parandalimit të këtyre fatkeqësive mund me pas ndikim edhe Inspektoriati i Komunës, ku dihet se punohet, rregullohet, ndërtohet rreth lumenjve, afër rrugëve kryesore. Asnjëherë nuk mbikëqyrët, thjesht gjithçka shkon këtu pa rregull edhe sallamadi. Unë e kisha ftuar kryetarin, qe tri vjet s'kam pa inspektor në terren, të asnjë fushe. Zonja kryesuese, është mirë me i bo thirrje inspektorëve komunalë, le të dalin pak, le të shohin çka po bëhet. Në secilin fshat, në secilin vend të kësaj Komune, vazhdimisht ngushtohen lumenjtë, zaptohet vendi i Komunës. Inspektorët vetëm vijnë këtu sillen edhe pijnë kafe, asnjëherë nuk dalin në terren me kqyr çka po ndodh edhe çka po bëhet. E kemi pa një vijë atje, të ndërtime në fshatin Bresanë. E nisin prej diku në krye edhe e qesin qatje në fushë, e lënë pa orientim dhe pa derdhje ajo. Thjesht, i merr ujnat diku me një pjesë të fshatit, i qet në rrugë kryesore në fund të fshatit Bresanë. Unë po besoj që disa prej ekzekutivit e kanë pa dje çka ka ndodhë atje në fund të Bresanës me atë vijën lake-luke që

keni dalë e keni ndërtue mandej, mas reagimit të qytetarëve nëpër Facebook. Është mirë me dalë me inspektue edhe me hulumtue kudo që ndërtohet, sidomos rreth lumenjve. Me kqyr e me marrë rrjedhën për dy dekada të fundit, ju mundeni me e pa ku janë konë lumenjtë edhe ku kanë mbri qetash. E, ma e keqja është që qeta zaptues të lumenjve, qeta ngushtues të lumenjve, janë subvencionue pas çdo vërshimi edhe me paret e subvencioneve ata, jo që e kanë rregullue shtratin e përrockave dhe lumenjve, po e kanë ngushtue hala ma shumë. Domethënë, me pare të Komunës ata e kanë dëmtue ma shumë, e kanë shkatërrue natyrën. Kjo është e keqja. Ju keni me dalë nesër me i subvencionue dëmet. Jam i sigurt, ne duhet me e bo këtë. Mirëpo, me qato pare të subvencioneve të Komunës, ne duhet me hulumtue çka po ndodh aty. Me qato pare ata marrin hala ma shumë e ngushtojnë lumin, që mas 4 viteve, mas këtij vërshimi ose kurdo që ndodh, me u bo dëmi hala më i madh, që me marrë hala ma shumë pare. Ishalla edhe në Buzez atje s'ka bo dëm, sikur në mandatin e kaluar, nja 4-5 mijë euro ia kishin dhënë njërit – 3200 euro në Buzez. Kam me e hulumtue këtë pjesën e subvencionimit. Unë dje kam dalë në terren, ta keni parasysht këtë. E di ku është bërë dëmi. Edhe mos me dalë në terren, po dihet ku është bërë dëmi, se i kemi mjetet e informimit. Ama mundohnu, qato pare që i jepni, të mos ngushtohen ma shumë lumenjtë se që janë konë. Aktivizoni këta inspektora komunalë, në të gjitha fushat, jo vetëm në ndërtim. E dini, kryetari ecën te ajo rruga Bresanë – Blaç vazhdimisht, te “Dilli” atje, te “Natyra”, non stop është terreni i lagur, sidomos dimrit aty, akull i madh bëhet. Edhe te ajo pjesa në dalje të Bresanës, tea jo shpia – kush ka shpi, ai vëllai Mulla Kasës atje, i hoxhës – aty kiameti po bëhet dimrit. Qitni inspektorat në terren, o vëlla! Ndërtohet gjys metre me rrugën kryesore. Nuk po e kuptoj këtë. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë para se me ia dhënë fjalën kryetarit, unë deshta me u kyç te Urani, që më tha për Inspektoriatin. Unë nuk e menaxhoj Inspektoriatin, edhe çdo pune, punës së huaj i thuash puna e mbarë. Inspektoriati i Komunës së Dragashit besoj që është duke e bërë punën më të mirë të mundshme. Në të gjithë botën, kur ndodhin vërshimet bëhen alarmante. Pak më herët e ka pas edhe Gjermania këtë, edhe kanë pësue shumë dëme. Këtu s'ka të bëjë as Inspektoriati e as kërkush, këto janë fatkeqësi natyrore që vijnë drejtpërsëdrejti. Unë nuk mundi me bo ndonjë send, po ju si Kuvend në qoftë se doni me i qit Inspektoriatin, atëherë ne marrim një vendim dhe bashkë me disa asambleistët dhe Inspektoriatin e Komunës dalim në punimet që do të kryhen. Faleminderit!

Uran Halimi: Zonja kryesuese, unë e di pozicionin tënd, në raport me ekzekutivin. Nuk kërkova nga ju personalisht me u marrë me Inspektoriatin, se jam i vetëdijshëm për çka foli. Unë s' un ta kërkoj ty edhe s' ta kërkova, s' di qysh e more ti. Unë kërkova nga ekzekutivi në përgjithësi që me u marrë me këtë çështje. Nuk thashë që ti duhesh me u marrë me Inspektoriatin, nëse e bëjsh je shumë gabim, znj. kryesuese. Ne mundim veç me marrë vendime ligjore, sa i përket asaj pjesës ligjore, ndërsa ekzekutivi nuk ka të bëjë me ju, znj. Kryesuese. Kuvendi dallon prej ekzekutivit. Unë fola në përgjithësi, te vendet ku janë subvencionue ma herët. Prapë aty ka me pas subvencionime. Edhe vërshimet, është e vërtetë që ndodhin, nuk po ju fajësoj juve edhe kërkond që kanë ndodhë vërshimet. Unë po them që me u sanue dhe me u intervenue në mënyrë të duhur, në ato vende ku vazhdimisht bëhen intervenime, ku vazhdimisht ka vërshime, ku vazhdimisht ka dëme materiale. Mos e merr personale, mos e lidhni gjithçka me politikë. Po kërkoj diçka për të mirën e qetij vendi, që nesër edhe kurdoqoftë, edhe shyqyr Zotit që s' kemi dëmtime në njerëz. Në aspektin material janë sende që rregullohen. Mirëpo, është mirë me u rregullue një herë e mirë që, ata qytetarët që jetojnë rreth atyre vendeve ku rrezikohen. Krijonju pak siguri më të qëndrueshme. Janë të njëjtat vende. Unë e mbaj në mend, në vitin '99 mas luftës, a në 2000 mos ka qenë, që kanë qenë do vërshime. Çohuni edhe më thoni që s' janë të njëjtat vende që janë rrezikue atëherë, e po rrezikohen edhe sot. A po? Është shumë e vërtetë. Të njëjtat vende ku kanë ndodhë vërshimet, ku ka pas dëmtime, ka pas dëmtime edhe në qeverisjen e kalume – s' e di në cilin vit saktë ka pas vërshime, ka qenë tash vonë në kohë të Pandemisë, në gusht saktësisht. Të njëjtat vende janë edhe dje çka kanë ndodhë. Janë subvencionue qato familje. Intervenoni në lumenj bre, s' është pa qare veç kocka me bo. Kur s' po intervenojmë në lumenj.. edhe koscat e Mahallës së Epërme që i themi në Blaç, kanë ardhë këtu poshtë në rrugë. Pse po intervenojmë në kocka, rregulloni një herë lumenjtë, se prapë qato kocka kanë me i bart ata lumenj. Është mirë një pjesë të investimeve me e orientue edhe kah ujërat. Kryetarin e mbaj në mend, e pat ndarë njëfarë buxheti për intervenim në sanim të ujërave, apo kuptojsh, se kanalizime s' kishte të drejtë me bo. Ndani pak buxhet, meqenëse e kemi edhe tash këtë parashikimin e buxhetit, e në shtator kemi me e votue buxhetin. Kisha sugjerue si qytetar, kryetar, një pjesë të fondeve orientoi edhe në këtë lëmi! Në kohë të fushatave, a e dish sa lumin e rregulloni, sa shtratin. Qetash s' po e shoh asnjë shirit t' u ia pre rregullimin e shtratit të lumit. Po preni shirita për kubëza, shirita për futboll, qytetarë edhe futbollistë më s' kanë mbet, u larguan për shkak të kushteve jo të favorshme këtu në Opojë edhe në Dragash në përgjithësi. Si propozim merreni pa anime politike. Kryetar, mbaj fjalët pak te sanimi i shtratit të

lumit. Është investue goxha pare te shtrati i lumit në fshatin Zaplluxhe edhe Blaç. Janë ata gypat që mas dy jave i ka marrë lumi i ka çue në Bellobrad a në Pllavë, s'e di ku i ka çue, bon vaki edhe në Kukës. Ndani do fonde për me rregullue ndonjë shtrat të lumit, ta bëjmë ndonjë lumë të bukur. Sa lumenj të mirë kemi, krejt të ndotur edhe të shkatërruar. Nga njëra anë, mos të kishin ndodhë këto vërshime edhe këto dëmtimet e qytetarëve, kjo sasia e madhe e ujit ka bërë edhe mirë, se goxha bërlllog ka marrë teposhtë. Qetash e ke momentin, kryetar, me intervenue në ndonjë shtrat të lumit, se bërlllog mo s'ka. Mundish me e hap ndojë projekt edhe ndonjë tender për rregullim të shtratit të lumit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë jo rastësisht e mora fjalën për Inspektoriat, se ti vetë e përmende emrin, kryetari me kryesuesen le t'i kqyrin inspektorat. Ndoshta unë jam gabim, por ka shumë këtu njerëz që e lype këtë edhe unë këtë përgjigje ta dhashë. Sa që për me ekzekutivin, i kam qysh i kam punët, unë jam kryesuese e Kuvendit, nuk bashkëpunoj me ekzekutivin, sa jam duke bashkëpunue me asambleistët. Të isha lut edhe një herë, se unë dallimin mes ekzekutivit dhe legjislativit e di shumë mirë. Kështu që, mos del me e marrë personale ne të dy! Faleminderit!

Uran Halimi: Më fal, a jam i pakuptueshëm, a nuk je në gjendje me më kuptue? Po thuesh krejt diçka tjetër prej asaj që unë po e them. Ose është duke të dhimbt dhëmbi diku, e po të shkon gjuha, po unë s'pata të bëj – mundohu mos me më ndërpre edhe merre fjalën prapë mandej, s'është problem – s'pata ndonjë qëllim edhe s'e thashë këtë ku ti po e qesish muhabetin. Raportet tua me ekzekutivin hiç s'më interesojnë. Edhe nuk thashë që kie raporte të mira ose të këqija, e kqyrim edhe në procesverbal, në seancë e kalume. Pse e marrish personale, znj.kryesuese? U luta si një qytetar i thjeshtë, për diçka të mirë për qeta qytetarë. Tash, nëse ka qëllime tjera, e shohim në vazhdim.

Bexhet Xheladini: Unë kur e mora fjalën, e përmenda situatën emergjente të krijuar pas vërshimeve, nuk due me i përsërit ato fjalët që i thashë unë edhe që pastaj në diskutim mori pjesë edhe kryesuesja. Ne kemi dhënë një informatë zyrtare në mjete të informimit edhe në uebfaqen e Komunës, për aktivitetin tonë që e kemi bo prej momentit kur qytetarët kanë fillue me lajmëruë për vërshimet. Ne mbrëmë deri në ora 01:00 kemi qenë në terren, jemi marrë me këtë punë, kemi bo punë aq sa kemi mund. Punën më të madhe që e kam bo, unë kam pas kontakte me qendrën, me AME-në, me drejtoreshën e Shërbimeve Publike të Prizrenit, me ministrin e MAPL-së kam pas bisedë. Sot po ashtu kam pas shumë biseda, kërkesa të cilat më janë realizuar dhe vetëm

cisternat për pastrimin e terrenit edhe zhbllokimin e kanalizimeve, veç janë nis me shkue nëpër fshatra. Tani edhe KFOR-i Turk më lajmëroi – e kam thirrë më herët – që do të del. Gjithashtu, do të vjen në takim prapë ministry, do të vjen një përfaqësues i AME-së, dhe ne si Kuvend Komunal, unë si kryetar do ta thirri një mbledhje urgjente të Qeverisë Lokale, do të formojmë Shtabin dhe Komisionin për Vlerësimin e Dëmeve. Gjithashtu, do ta bëjmë një kërkesë urgjente Qeverisë që të na lëshojë një sasi të mjeteve preliminare për sanimin e gjendjes, se janë disa punë që nuk presin, sidomos dëmtimet që janë bërë në infrastrukturë publike, ato duhet t'i sanojmë sa më shpejt. Procesi i sanimit veç ka fillue, sot më lajmëruan që në terren kanë dalë ekskavatorë të ndryshëm të cilët janë duke punuar. I lutem Zotit që të mos ketë rënie të tjera të shiut, se shtretërit e lumenjve ende janë pa pastruar mirë, ka edhe shumë mbetje. Por, me këtë çështje do të merremi ne. Kështu që, unë e pres edhe ndihmën e juaj, sepse vërshimet ndodhin, janë fuqi mbinatyrore. Vërshime, tërmete, furtuna, era ndodhin çdo kund në botë, ato janë fuqi e Zotit, s'mund t'i ndalim. Edhe shtetet më të përgatitura në botë nuk mund t'i ndalin vërshimet. Këtë vit ka pas vërshime çdo kund, edhe te ne. E keqja është që patëm vërshime, po e mira e kësaj është që nuk patëm as lëndime, as viktima. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë e mbyllim këtë takim. Faleminderit!

Kryesuesja e KFP-së

Arijeta Skeraj